



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 8, datë 27.04.2023**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin prill, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:20

Data e mbajtjes së mbledhjes : 27.04.2023

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! I nderuar Zëvendëskryetar!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin prill të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë. Do kemi gjithashtu dhe informim nga drejtues të administratës së bashkisë. I gjithë dokumentacioni Ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga Sekretaria e Këshillit. Ftoj sekretaren të proçedoj me thirrjen e emrave të këshilltarëve.

**Dorina Milja:** Përshëndetje! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... mungon.....deri tek.... Morena Boja...mungon.

Gjithsej 29 këshilltar në sallë.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e rendit të ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN PRILL 2023
Pika 2. Informim Këshilltarëve	RAPORT MBI VEPRIMTARINË AUDITUESE TË DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM (01.01.2022-31.12.2022)
*****	DISKUTIME DHE PYETJE

Atëherë kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 29 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale znj.Klementina Meçi.

**Klementina Meçi**: Faleminderit. Mirëdita të gjithëve!

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën 1 të rendit të ditës dhe vendosi me vota unanime ta kaloj në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?...Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 29 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Për **pikën 2** që është informim i këshilltarëve, pikë e cila është vendosur për t'u marrë në shqyrtim sipas programit vjetor të punës së këshillit në mbështetje të VKB-së nr.139, datë 24.11.2022. I jepet fjala Drejtoreshës së Njesisë së Auditimit të Brëndshëm në Bashkinë Durrës znj. Majlinda Palodhi për "Raportin mbi veprimtarinë audituese të Drejtorisë së Auditimit të Brëndshëm pranë Bashkisë Durrës për vitin 2022"

**Majlinda Palodhi** : Përshëndetje !

“Njësia e Auditimit të Brëndshëm pranë Bashkisë Durrës e kryen veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur.....” .....lexon raportin e e dorëzuar me nr. prot.2440/2, datë 27.03.2023 pranë Sekretarisë së Këshillit Bashkiak.

**Ani Dyrmishi** : Ka ndonjë pyetje ?

Po Klementina.

**Klementina Meçi** : Ju thatë që për mendimin Tuaj institucionet e varësisë duhet të kenë një staf më të kualifikuar. Unë doja të pyesja nëse është informuar ky staf që të bëjnë trajnime? Apo janë afishuar këto trajnime në institucionet përkatëse?

**Majlinda Palodhi** : Trajnimet bëhen nga ASPA dhe ato punonjës të administratës janë më Kod Pune dhe nuk kanë statusin e nënpunësit civil. Bëhen me përzgjedhje. Për mendimin tim cilësia e stafit lë për të dëshiruar.

**Ani Dyrmishi** : Edhe përsa i përket Kodit të Punës ka kritere për përzgjedhjene e stafit. Pra, ai që plotëson kriteret përzgjidhet. Se po flasim këtu për administratën, dhe nëse po atëherë mund të lesh rekomandime për kritere shtesë nëse mendoni se ai specialist në atë pozicion pune nuk përshtatet.

**Majlinda Palodhi** : Po, ne jemi auditues dhe japim mendimin tonë.

**Etleva Velçani** : Por kur nuk është specialisti i duhur në pozicionin e duhur ?

**Majlinda Palodhi** : Jo nuk ka patur raste të tilla se ndryshe do e kisha lën si rekomandim. Mendoj që specialistët t’i marrin më cilësor.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Fjalën për diskutim nuk e ka kërkuar ndonjë këshilltar.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Mbledhja e ardhshme do të njoftohet nga Sekretaria e Këshillit. Ju faleminderit.

*Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 4 (katër) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit, sipas Rregullores së Këshillit dhe Proçesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.*

**Mbajtësi i proçesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Përfaqësues i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI